20262183538

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 35 të Ligjit për Ekzekutimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 253/25), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen e mbajtur më 15 shtator 2026, miratoi

PROGRAMI PËR NDRYSHIMIN E PROGRAMIT PËR MBËSHTETJEN E SIGURISË SOCIALE TË GRAVE QË USHTROJNË VEPRIMTARI BUJQËSORE PËR VITIN 2026

I

Në Programin për mbështetjen e sigurisë sociale të grave që ushtrojnë veprimtari bujqësore për vitin 2026 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 29/26), në pjesën I, paragrafi (2) ndryshohet dhe bëhet si vijon:

„(2) Mjetet për realizimin e këtij programi, në shumën e përgjithshme prej 2.500.000,00 denarësh, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 253/25 dhe 174/26), ndarja 14004, nënprogrami 23, zëri 464 – transferta të ndryshme, të cilat nga ana e Agjencisë për Mbështetjen Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në tekstin e mëtejmë: Agjencia) do të shfrytëzohen për mbështetje financiare në shumën prej 100.000,00 denarësh për kompensim të lehonisë për periudhë nëntëmujore për gratë që kanë statusin e personit të siguruar – bujq individual, të fituar në përputhje me Ligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor.“

Paragrafi (3) ndryshohet dhe bëhet si vijon:

„(3) Një pjesë e mjeteve nga paragrafi (2) i kësaj pjese, në shumën prej 100.000,00 denarësh, janë të destinuara për detyrimet e papaguara nga Programi për mbështetjen e sigurisë sociale të grave që ushtrojnë veprimtari bujqësore për vitin 2025.“

II

Ky program hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Nr. 57- 6785/10

15 Shtator 2026
Shkup

Kryetar i Komisionit dhe
zëvendëskryetar i Qeverisë së
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Ljupço Dimovski, n.p